



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJEN VENDORE

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI I GRUPIT TEKNIK TË PUNËS SË PERFORMANCËS LIDHUR ME
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2024 NË FUSHËN E MBROJTJES SOCIALE DHE
BARAZISË GJINORE**

Tiranë, 11 Prill 2025

Hapja e mbledhjes

Mbledhja u hap nga Z. *Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar i AMVV* i cili përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre. Ai u shpreh se qëllimi i takimit ishte diskutimi i treguesve që lidhen me mbrojtjen sociale dhe barazinë gjinore. Ai nënvizoi rëndësinë e përfshirjes së treguesve të rinj, të matshëm dhe të besueshëm, të cilët mund të japin një pasqyrë më të qartë dhe reale mbi mënyrën sesi funksionon pushteti vendor në këto fusha. Qëllimi përfundimtar është përmirësimi i vazhdueshëm i Sistemit të Matjes së Performancës dhe rritja e transparencës së tij.

Çështje të diskutuara

Znj. *Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, AMVV* prezantoi gjetjet e ushtrimit të realizuar gjatë vitit 2024, i cili është pasqyruar në një publikim të dedikuar dhe përfshiu disa fusha, ndër të cilat paraqiteshim me tregues edhe **mbrojtja sociale dhe barazia gjinore**.

Disa nga gjetjet e SMP 2023:

- Mesatarisht **8%** e familjeve përfitonin ndihmë ekonomike në nivel kombëtar, ndërkohë që **31.8%** e familjeve jetonin nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër;
- Shkalla e miratimit për strehimin social rezultoi **40%**;
- Në Bashkinë e Tiranë, vetëm **1.2%** e familjeve përfitonin ndihmë ekonomike – një përqindje dukshëm më e ulët se mesatarja kombëtare prej **8%**;
- Bashkitë me dendësi të ulët të biznesit shfaqin një varësi më të lartë nga ndihma ekonomike;
- Fusha sociale lidhet ngushtësisht edhe me potencialet që kanë bashkitë në bazë të shpërndarjes gjeografike. **Rajoni lindor i Shqipërisë** paraqiti shkallë të lartë, me të paktën **15%** të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike;
- Është e nevojshme që në vlerësimin e treguesve të merret parasysh edhe numri i individëve apo familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë.
- Referuar të dhënave të MSHMS, **95% e aplikuesve për ndihmë ekonomike janë përfitues të kësaj skeme**.

Komente:

Treguesit e shërbimit social të pandryshuar:

1. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike;

Znj. *Majlinda Nesturi, Data analyst, UN Women* ngriti çështjen e matjes së treguesve sipas gjinisë së kryefamiljarit, duke shtuar se një ndarje e tillë do të ishte e vlefshme për të kuptuar më mirë përfitimin e shërbimeve sociale në raport me barazinë gjinore.

Znj. Vera Breçani, Specialist, INSTAT u shpreh se, në parim, është e mundur që të dhënat të ndahen sipas gjinisë së kryefamiljarit. Megjithatë, ajo theksoi se numri i grave që figurojnë si kryefamiljare është shumë i vogël. Sipas saj, kjo lidhet edhe me një sërë faktorësh dhe problematikash sociale që ndikojnë në këtë situatë.

Znj. Caca shprehu se ky tregues duhet të mbetet prioritet edhe këtë vit. Gjithashtu u propozua që të përfshihen edhe **dy** treguesit e tjerë të pandryshuar:

2. Shkalla e miratimit të strehimit social;

3. Numri i qendrave sociale komunitare publike për 10,000 banorë.

Znj. Nesturi u interesua në lidhje me mundësinë e ndarjes së qendrave sociale komunitare dhe kategorizimin në mënyrë që të matet më saktë lloji i shërbimit të ofruar në secilën prej tyre.

Znj. Pamela Memo, Specialist, Shërbimi Social Shtetëror sqaroi se kategorite e qendrave i ndajme në qendra të përkujdesit shoqëror rezidenciale dhe ditore. Qendrat komunitare bëjnë pjesë në qendrat që japin shërbime ditore. Në qendrat që ofrojnë shërbime rezidenciale bëjnë pjesë shtëpitë e fëmijëve, shtëpitë e të moshuarve, strehëzat për gratë viktime të dhunës, strehëzat për viktimat e trafikimit, qendrat e emergjencës.

Statistika Zyrtare e raportuar nga bashkitë sipas Udhezimit Nr.1945 drejtuar SHSSH, për qendrat që ofrojnë shërbime sociale është e grumbulluar dhe i kategorizuar sipas kategorive përfituese, të përcaktuara në nenin 6 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”; sipas tipologjisë së shërbimit: rezidenciale/ditore; sipas formës së financimit publike/jopublike. Bashkia nuk e dergojnë informacionin e kërkuar sipas qendrave specifike, kjo na e bën të pamundur identifikimin e qendrave komunitare që ju kerkoni.

Znj. Papajani sqaroi se po punohet për rishikimin e modultit të statistikave, ku do të përfshihet dhe raportimi i të dhënave sipas tipologjive të shërbimit të përcaktuar në ligjin e shërbimeve, përfshirë dhe shërbimet komunitare apo multifunkionale.

Gjithashtu u sqarua se të gjithë shërbimet, bazuar në standardet e ofrimit të shërbimit, duhet të jenë të pajisura me licencë nga QKB. Qendrat ditore/shërbimet komunitare e marrin direkt nga QKB, ndërkohë qendrat rezidenciale kalojnë për shqyrtim nga Komisioni i Licensave, të ngritur pranë Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

Znj. Ornela Shapo, Ekspert, Shapo Consulting shpjegoi se janë përgatitur pashaporta për qendrat komunitare, të cilat përfshijnë edhe shkollat publike 9-vjeçare që ofrojnë shërbime jashtë mësimdhënies. Ajo theksoi se të gjitha bashkitë, sipas matjeve që janë bërë, kanë raportuar për shërbimet sociale në përputhje me ligjin.

Znj. Caca theksoi se në të gjithë vendin ka rreth **200 qendra komunitare** dhe disagregimi i mëtejshëm do ta humbiste vlerën e tij. Fillimisht treguesi ishte i shprehur për 1,000 banorë, por pasi numri i qendrave ishte shumë i vogël, u vendos që të merret si standard **10,000 banorë**, për të pasur një pamje më përfaqësuese të të dhënave.

Znj. Shapo theksoi se për të bërë të krahasueshme bashkitë me njëra-tjetrën, duhet të merret parasysh popullsia mbi të cilën ofrohen këto shërbime. Ajo shtoi se gjithashtu duhet të sigurohet

që të dhënat të jenë të përfaqësueshme, dhe duhen të dhëna të sakta për numrin e popullsisë vulnerabël, për të vlerësuar se sa përfaqësuese janë këto shërbime për komunitetin.

Znj. Caca kërkoi dakordësimin për treguesit ekzistues dhe kaloi prezantimin me **treguesit e rinj propozuar për t'u shtuar:**

1. **Numri gjithsej i rasteve të raportuara të dhunës në familje, sipas gjinisë, moshës dhe llojit të dhunës;**
2. **Përqindja e viktimave të dhunës në familje që marrin mbështetje ekonomike.**

Znj. Nesturi u shpreh se, përveç **numrit total të rasteve**, është e rëndësishme të përfshihet edhe **numri i viktimave dhe numri i rasteve të referuara**. Ajo shpjegoi se, shpesh, ka raste që nuk e ndjekin gjithmonë mekanizmin e raportimit, pasi disa viktimë preferojnë të shkojnë në bashki dhe nuk raportojnë në polici. Kjo mund të sjellë disa diferenca të vogla, por është e rëndësishme që të përfshihet edhe procesi i referimit.

Znj. Aulona Hazbiu, Eksperte, Bashki të Forta theksoi se bashkia nuk ka lidhje direkte me raportimin e rasteve të dhunës në familje. Ajo mund të ofrojë vetëm këshillim dhe mund të orientojë viktimat në lidhje me mekanizmin e duhur.

Znj. Nesturi shprehu interesin për të ditur sa mirë raportojnë bashkitë në lidhje me referimin e këtyre treguesve, duke theksuar rëndësinë e mbledhjes së të dhënave të sakta për procesin e referimit të rasteve të dhunës në familje

Z. Llavdaniti theksoi se është e nevojshme të gjendet një **tregues i mesëm i artë për bashkitë**, i cili do të mundësojë krijimin e një treguesi të matshëm dhe do të sigurojë që të dhënat të jenë më të sakta.

Znj. Nesturi shpjegoi se ky tregues i referohet rasteve të raportuara në polici, ndërsa bashkitë mbajnë një sistem **REVALB**, i cili do të thotë se çdo bashki ka të dhëna të detajuara, ku raportohen rastet me shumë variabla. Ajo theksoi se ky sistem është gjithmonë në përmirësim dhe po bëhet gjithnjë e më i avancuar.

Znj. Shapo sqaroi se vitin e kaluar, në kuadër të diskutimeve, u sugjerua nga MSHMS përfshirja e një treguesi shtesë që lidhet me shërbimet sociale. Duke pasur parasysh numrin e lartë të të dhënave sociale, MSHMS vlerësoi se do të ishte më e përshtatshme të përfshihej treguesi: **“Numri i shërbimeve sociale që ofrohen në bashki, si dhe numri i përfituesve për çdo shërbim.”** Ky tregues synon të japë një pasqyrë më të plotë dhe konkrete mbi aksesin dhe përfitimin nga shërbimet sociale në nivel vendor.

Z. Llavdaniti sugjeroi që të përfshihet një tregues që **mat numrin e rasteve të trajtuara ndaj atyre të raportuara**, për të pasur një panoramë më të saktë të reagimit institucional.

Znj. Shapo u shpreh se mund të merret parasysh edhe mundësia e përfshirjes së një shërbimi për fëmijët, duke theksuar se kjo do të ofronte një mbështetje të plotë dhe të përshtatshme për grupmoshën e fëmijëve, duke përfshirë aspekte të tjera që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre.

Znj. Nesturi theksoi se, sipas dijenisë së saj, jo çdo bashki ka një punonjës të dedikuar për këtë aspekt, duke nënkuptuar se mund të ketë dallime në nivelin e shërbimeve dhe mbështetjes që ofrohen nëpër bashki të ndryshme.

Z. Llavdaniti theksoi se vitin e kaluar u realizua një fushatë nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, gjatë së cilës u emëruan koordinatorë për fëmijët në çdo bashki. Ai theksoi gjithashtu se databaza për këtë qëllim është plotësuar dhe është në dispozicion, duke siguruar një sistem të centralizuar dhe të organizuar për mbështetje dhe koordinim në nivel lokal.

Znj. Shapo theksoi se bashkitë raportojnë gjithashtu për numrin e fëmijëve në gjendje rruge dhe ata që janë trajtuar, duke përfshirë shtresat vulnerabël dhe pakicat kombëtare. Ajo theksoi rëndësinë e këtij raportimi, pasi ndihmon në monitorimin dhe adresimin e nevojave specifike të këtyre grupeve, duke siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në shërbime dhe mbështetje të nevojshme.

Znj. Xhilda Papajani, Përgjegjëse, MSHMS theksoi rëndësinë e mënyrës së mbledhjes së të dhënave dhe saktësisë e informacionit, duke siguruar që proceset e mbledhjes të jenë të qarta dhe të besueshme. Zakonisht, shkolat për t'iu shmangur procedurave të gjata marrin licencat për shërbimin komunitar, për të evituar marrjen e licencës për fushën e arsimit, e cila kërkon shumë dokumente. Ajo shtoi se këto licenca janë revokuar dhe se licenca e duhur merret në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Znj. Shapo sugjeroi që në pasaportën e tregueseve të shtohet dhe fjala “me licencë” sipas ligjit të shërbimeve sociale, për të siguruar që ata të jenë të licencuar dhe të veprojnë në përputhje me rregullat dhe kërkesat ligjore përkatëse.

Znj. Papajani shpjegoi se po punohet për krijimin e një harte digjitale shërbimesh, ku çdo bashki do të ketë të gjitha shërbimet dhe tipologjitë e tyre të pasqyruara. Kjo hartë do të jetë e integruar në sistemin e MSHMS dhe në sistemin e regjistrit elektronik, duke siguruar një qasje të centralizuar dhe të përditësuar për shërbimet që ofrohen në nivel vendor.

Znj. Papajani sugjeroi që treguesi i **përqindjes së viktimave të dhunës në familje që marrin mbështetje ekonomike** të zevendësohet me një tregues tjetër të shërbimeve sociale. Nga harta e përditësuar e shërbimeve sociale (dorëzuar drafti i parë Prill 2025) rezulton se të rriturit me AK janë grupi më kritik, në nevojë për shërbime, i konsideruar si i tillë, në më shumë se 80% të bashkive të vendit.

Sa me sipër ajo sugjeroj formulimin e indikatorit si më poshtë vijon: **“Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të refruar nga Komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje me shërbime sociale”**. Ky tregues mundeson matjen e mbulimit me shërbime të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, duke i dhënë prioritet PAK 21+. Të dhënat bazohen te numri i rasteve të hedhura në sistemin elektronik të shërbimeve shoqërore MIS-SHKSH, si dhe bazuar në analizën e nevojave të Planeve Sociale.

Diskutime mbi treguesit e barazisë gjinore, bazuar në gjetjet e SMP 2023:

Znj. Caca vazhdoi prezantimin duke paraqitur gjetjet kryesore mbi barazinë gjinore. Ajo theksoi se përqindja e grave drejtuese në qeverisjen vendore rezultoi mesatarisht 44%. Bashkitë më të vogla raportojnë një përqindje më të ulët të grave në pozicione drejtuese, rreth 37%, ndërsa në bashkitë e mëdha rritet përfaqësimi i grave me 44% dhe deri në 61% në Tiranë. Ajo vuri në dukje se bashkitë më të vogla dhe ato me zhvillim ekonomik më të kufizuar kanë një përfaqësim më të ulët gjinor.

Znj. Caca prezantoi treguesit e propozuar të disagregohen nga treguesi ekzistues i SMP 2023: Përqindja e grave në pozicione drejtuese sugjerohet të ndahet në dy tregues të veçantë:

- 1. Përqindja e grave në pozicione: kryetar, zëvendëskryetar, këshilla bashkiakë dhe administrator;**
- 2. Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki.**

Komente:

Z. Xhekson Cela, Specialist, MSHMS theksoi se indikatorët janë të rregullt, por shtoi se problemi qendron në realizimin e implementimit të tyre. Ai sugjeroi që të vendoset një target rreth 50%, për të siguruar një qëllim të arritshëm dhe të matshëm në përpjekjet për të rritur përfaqësimin e grave në pozita drejtuese në qeverisjen vendore.

Znj. Caca propozoi shtimin e një treguesi të ri për barazinë gjinore:

- 1. Përqindja e buxhetit vendor të alokuar për iniciativa që mbështesin barazinë gjinore në secilin program buxhetor vendor.**

Ky tregues do të ndihmojë në monitorimin e angazhimit financiar për nismat që promovojnë barazinë gjinore në nivel lokal. Gjithashtu, shtoi se ky tregues do të mundësohet nga MF dhe jo nga vetë-raportimet nga bashkitë.

Znj. Shapo theksoi se ky tregues nuk është i matshëm, duke theksuar se nuk ka një mënyrë të qartë dhe të saktë për të matur përqindjen e buxhetit të alokuar për iniciativat për barazinë gjinore në nivel lokal. Një shqetësim nga shumica e pjesëmarrësve ishte se sa i besueshëm është ky informacion dhe si nxirret ai nga Thesari. Ata theksuan se ky problem është një nga barrierat kryesore për të siguruar saktësinë dhe transparencën e të dhënave në lidhje me alokimin e buxhetit për barazinë gjinore.

Përfundime

Në fund të takimit u dakordësua për propozimin e treguesve për **Mbrojtjen Sociale**:

- 1. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike;**

2. Shkalla e miratimit të strehimit social;
3. Numri i qendrave sociale komunitare publike për 10,000 banorë;
4. Numri gjithsej i rasteve të trajtuara kundrejt rasteve të raportuara të dhunës në familje, sipas gjinisë, moshës dhe llojit të dhunës;
5. Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të refruar nga Komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje me shërbime sociale.

U miratuan edhe propozimet mbi treguesit e Barazisë Gjinore:

1. Përqindja e grave në pozicione: kryetar, zëvendëskryetarë, këshilla bashkiakë dhe administratorë;
2. Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki;
3. Përqindja e buxhetit vendor të alokuar për nisma që mbështesin barazinë gjinore në secilin program buxhetor vendor. U miratua ky tregues i ri i propozuar i barazisë gjinore, i cili nuk do të raportohet nga bashkitë, por do të sigurohet nga MF. Gjithashtu në bazë të dhënave që do të mblidhen dhe analizohen do të vendoset për përfshirjen e tij në raportin e publikuar të SMP 2024.